



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE JO PUBLIKE PËR LIDHJEN E KONTRATËS ME FONDIN

Institucioni shëndetësor jopublik i interesuar të lidhë/rilidhë kontratën me DSHSU/DRF aplikon nëpërmjet platformës e-Albania sipas formularit përkatës për lidhjen e kontratës bazuar në kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues.

DSHSU/DRF administron dosjen e dokumentacionit dhe gjithë procesin për lidhjen/rilidhjen e kontratës me institucionet shëndetësore jopublike brenda një afati kohor 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

Kriteret që duhet të plotësojnë institucionet shëndetësore jopublike për lidhjen e kontratës me Fondin janë:

1.1 Kriteria të përgjithshme:

- a) Institucioni shëndetësor jopublik duhet të jetë i licencuar pranë QKB-së për shërbimin shëndetësor që do kontraktohet;
- b) Institucioni shëndetësor jopublik duhet të jetë i regjistruar pranë organeve tatimore në rajonin ku kryen aktivitetin;
- c) Institucioni shëndetësor jopublik duhet të jetë me llogari bankare në një bankë të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë;
- d) Institucioni shëndetësor jopublik duhet të jetë i pajisur me pajisjet e nevojshme kompjuterike dhe krijimin e një database/programi, i cili të instalohehet dhe të jetë i aksesueshëm online nga Fondi;
- e) Mjekët specialistë, të cilët do të kryejnë procedurat e paketave shëndetësore të miratuara dhe të kontraktuara nga Fondi, nuk duhet të jenë të punësuar në institucionet shëndetësore publike;

- f) Mjekët specialistë, të cilët do të kryejnë procedurat e paketave shëndetësore të miratuara dhe të kontraktuara nga Fondi, nuk kanë thyer marrëveshjen me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në lidhje me përfitimin e specializimeve pasuniversitare;
- g) Institucioni shëndetësor jopublik nuk duhet të jetë në procedurë falimentimi dhe likuidimi.

1.2 Kritere të veçanta:

Kriteret e veçanta janë specifike sipas shërbimit që kontraktohet.

1.2.1 Për shërbimin e dializës:

- a) Institucioni shëndetësor jopublik, duhet të ketë laborator kliniko-biokimik e mikrobiologjik, pranë çdo qendre të ofrimit të paketës së hemodializës;
- b) Shërbimi i dializës do të kryhet pranë qendrave që kanë në dispozicion qendër spitalore, e cila ka minimumi shërbim urgjence, sëmundje interne, kardiologji, nefrologji dhe shërbim intensiv me minimumi 3 shtretër;
- c) Pajisja e laboratorëve mjekësorë me licensën e mjekut dhe drejtuesit teknik;
- d) Të ketë minimumi dy mjekë të punësuar me kontratë pune me kohë të plotë, ku minimumi të ketë një mjek specialist nefrolog;
- e) Të ketë shërbimin e urgjencës 24 orë për paketën shëndetësore të dializës;
- f) Të ketë minimalisht 5 (pesë) aparate të dializës me shtretër përkatës;
- g) Të ketë 3 (tre) shtretër të veçantë për pacientët me hepatit të tipeve të ndryshme;
- h) Të ketë një aparat të lëvizshëm të dializës, i cili të bëjë dhe hemodiafiltracion dhe biofiltracion;
- i) Të ketë në pronësi një autoambulancë në gjendje gadishmërie, me kohë të plotë.
- j) Institucioni të ketë të punësuar minimalisht 1(një) infermier për 5(pesë) pacientë;
- k) Institucioni të sigurojë staf të kualifikuar. Stafi mjekësor duhet të kryejë në mënyre periodike trajnime dhe ti dëshmojë nëpërmjet krediteve sipas kërkesave të edukimit në vazhdim.

1.2.2 Për shërbimin e vendosjes së fistulës së thjeshtë/graftit të thjeshtë:

- a) Institucioni shëndetësor jopublik duhet të ofrojë shërbimin e dializës;
- b) Të ketë një mjek të punësuar me kontratë pune me kohë të plotë, mjek specialist angiolog/angiokirurg;
- c) Të ketë një mjek të punësuar me kontratë pune me kohë të plotë, mjek specialist reanimator;
- d) Institucioni shëndetësor jopublik duhet të ketë sallë operacioni ;
- e) Institucioni shëndetësor jopublik të ketë shërbim radiologjie;

1.2.3 Për shërbimin e kardiologjisë:

- a) Të ketë minimumi katër mjek të fushës së kardiologjisë të punësuar me kontratë pune me kohë të plotë në institucion. Duhet të ketë minimumi dy mjek anestezistë reanimator të punësuar me kontratë pune me kohë të plotë;
- b) Të ketë minimumi gjashtë shtretër në shërbimin e kardiologjisë dhe një sallë angiografie, të ketë minimumi katër shtretër në reanimacionin e shërbimit të kardiologjisë invazive. Të ketë të gjitha asetet/pajisjet mjekësore të shërbimit të kardiologjisë invazive;
- c) Të ketë një shtrat (vend të lirë) dedikuar për referimet urgjente që vijnë nga Fondi ;
- d) Të ketë shërbim urgjence 24 orë të mbuluar me mjekë;
- e) Të ketë në pronësi një autoambulancë në gjendje gadishmërie, me kohë të plotë.

1.2.4 Për shërbimin e kardiokirurgjisë:

- a) Të ketë minimumi dy mjekë të fushës së kardiokirurgjisë të punësuar me kontratë pune me kohë të plotë në institucion. Duhet të ketë minimumi dy mjekë anestezistë reanimator të punësuar me kontratë pune me kohë të plotë;
- b) Të ketë minimumi pesë shtretër në reanimacionin e kardiokirurgjisë, pesë shtretër në shërbimin e kardiokirurgjisë, si dhe dy salla operatore, që i përkasin operacioneve vaskulare. Të ketë të gjitha asetet/pajisjet mjekësore të sallës operatore kardiokirurgjikale përfshirë dhe Balonë Intraaortike (IABP);
- c) Të ketë një shtrat (vend të lirë) të dedikuar për referimet urgjente që vijnë nga Fondi;
- d) Të ketë shërbim urgjence 24 orë të mbuluar me mjekë;
- e) Të ketë në pronësi një autoambulancë në gjendje gadishmërie, me kohë të plotë.

1.2.5 Për shërbimin e transplantit të veshkës dhe flakjes akute:

Të plotësojë kriteret e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 206, datë 13.03.2013, “Për përcaktimin e kriterëve për hapjen dhe mbylljen e qendrave të transplantimit”, lidhur me:

- a) Kriteret e veçanta të ndërtimit;
- b) Kriteret për personelin mjekësor në qendrën e transplantimit;
- c) Kriteret për ruajtjen e dokumentacionit të aktivitetit të qendrës;
- d) Pajisjet e nevojshme për sallën e operacionit, reanimacionin dhe dhomat e pacientëve.

1.2.6 Për shërbimin e implantit koklear:

- a) Të ketë të kontraktuar të paktën1 (një) mjek specialist otorinolaringolog të specializuar për vendosjen e implantit koklear ;
- b) Të ketë të paktën 1(një) bllok operator-reanimacioni, sipas standardeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.